U kap me kallashnikov në banesë, arrestohet 48-vjeçari në Elbasan. I dënuar për...

15 Prill, 2024 09:55

Madhësia e tekstit:

Një 48-vjeçar ka rënë në prangat e policisë së Elbasanit, pasi akuzohet për armëmbajtje pa leje. Burime zyrtare bënë me dije se pas hekurave ra shtetasi me inicialet K. R., i cili u kap me kallashnikov në banesë.

NJOFTIMI I POLICISE

Finalizohet operacioni policor i koduar "Recidivist", kundër armëmbajtjes pa leje. Operacioni i zhvilluar nga Komisariati i Policisë Elbasan, është rezultat i ndjekjes me metoda proaktive, të informacioneve të siguruara nga inteligjenca policore. Mbante në banesë, armë zjarri kallashnikov, arrestohet në flagrancë 48-vjeçari, i dënuar më parë për armëmbajtje pa leje dhe për dhunë në familje.

Sponsored Links

Sekuestrohet arma e zjarrit kallashnikov. Shërbimet e Komisariatit të Policisë Elbasan, në vijim të punës me fokus evidentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të posedimit të kundërligjshëm të armëve të zjarrit, në zbatim të masave të përcaktuara në planin operacional mbarëkombëtar "Sundimi i ligjit", kanë siguruar informacion se një shtetas mbante armë zjarri.

Ky informacion është ndjekur proaktivisht, në bashkëpunim me Prokurorinë e Elbasanit dhe si rezultat është finalizuar operacioni policor "Recidivist". Në kuadër të këtij operacioni, në banesën e shtetasit K. R., në lagjen "Skënderbej", shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale një armë zjarri kallashnikov. Në vijim të veprimeve procedurale për këtë rast, u arrestua në flagrancë shtetasi K. R., 48 vjeç, për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe municionit". Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për veprime të mëtejshme.

SONDAZH

Bardhi deklaroi se opozita do të shpallë kandidat për Kryeministër. Me kë mund të fitojë më shumë votat?

Me Berishën
Kandidat tjetër
Nuk e di

Ad

Voto

Rezultatet

Për t'u bërë pjesë e grupit '**Balkanweb**' mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: arme | arrestim | Elbasan

BW Download on the App Store | GET IT ON Google Play

Kerko ketu

LAJMET E FUNDIT

VIDEO/ Vendos Tchouameni, Reali edhe më pranë titullit kampion në Spanjë
15 Prill, 2024

"Furtunë në gotë", Avokatja e Popullit, Ballanca komenton deklaratën e Dumanit në KLP: U nxor nga kontekesti
15 Prill, 2024

"Kam 600 gjyqe me këta"/ Salianji nuk ndalet: Do denoncoj çdo aferë të njerëzve të qeverisë
15 Prill, 2024

"S'kam akuzë për abuzim, shpërdorim apo korrupsion", Salianji: Jam i vetmi politikan që gjykohem penalisht pse "luftoj" qeverinë
15 Prill, 2024

VIDEO/ Fitore e thellë ndaj Tottenham, Newcastle dhuron show në shtëpi
15 Prill, 2024

Meritoni i kërkon falje Rikes me një letër
15 Prill, 2024

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

TË NGJASHME

Kundërshtoi vendimin e gjykatësES dhe tentoi ta godiste, arrestohet Iushejari
15 Prill, 2024

Akuza për kultivim droge, "arrest me burg" për dy të arrestuar, prifet masa për vëllanë e deputetit të PS
15 Prill, 2024

TabOola Feed

VIDEOLAJM/ Plas e qeshura në Kuvend, Spiropali-Tabakut: Ju ka marrë malli për ne
balkanweb.com

Deklarata e papritur e Ori Nebijajt, flet për partnerin: Kam dy vite me të, por...
balkanweb.com

LAJM I FUNDIT
MOST POPULAR
U plagos rëndë në aksident, ndërron jetë pasagjerja 24-vjeçare
balkanweb.com

MOST POPULAR
"Balluku filloi të numërojë paratë"/ Gazetari jep lajmin "bombë": Shell tërhiqet nga kërkimet për naftë në Shpirag
balkanweb.com

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Makina përfshihet nga flakët në aksin Thumanë-Milot, shpëton mrekullisht drejtuesi
15 Prill, 2024

U plagos rëndë në aksident dhe ra në koma, ndërron jetë 24-vjeçarja te Trauma
15 Prill, 2024

Shkaktoi aksidentin me 4 të plagosur në Prenjas-Qafë Thanë, ndalohet shoferi
15 Prill, 2024

Posedonte katër thika në lokalin e tij dhe ushtronte aktivitet pa licencë, arrestohet 52-vjeçari në Korçë
15 Prill, 2024

Arrestohet 49-vjeçari në Durrës, hodhi inerte në vijën bregdetare
15 Prill, 2024

Dhunoi psikologjikisht vëllanë, procedohet penalisht 45-vjeçari në Roskovec
15 Prill, 2024

KATEGORIA VIDEO

VIDEO/ Vendos Tchouameni, Reali edhe më pranë titullit kampion në Spanjë
15 Prill, 2024

"Furtunë në gotë", Avokatja e Popullit, Ballanca komenton deklaratën e Dumanit në KLP: U nxor nga kontekesti
15 Prill, 2024

"Kam 600 gjyqe me këta"/ Salianji nuk ndalet: Do denoncoj çdo aferë të njerëzve të qeverisë
15 Prill, 2024

"S'kam akuzë për abuzim, shpërdorim apo korrupsion", Salianji: Jam i vetmi politikan që gjykohem penalisht pse "luftoj" qeverinë
15 Prill, 2024

VIDEO/ Fitore e thellë ndaj Tottenham, Newcastle dhuron show në shtëpi
15 Prill, 2024

Meritoni i kërkon falje Rikes me një letër
15 Prill, 2024

© 2024 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.